



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit.
Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive
Shkolla e Mesme Profesionale
"Charles Telford Erickson"
Golem – Kavaje

shkollaemesmeagrobiznesgolem@yahoo.it

Tel.0693870484 .

Nr 126 prot

Golem më 19 , 03 ,2024.

Lenda:Njoftim per levizje paralele.

Drejtoria Juridike dhe Burimeve Njerezire
Drejtoria e Maredhenieve me Publikun
Agjensia Kombetare e Punesimit dhe Aftesive

Në mbështetje të Ligjit nr.15/2019 "Per nxitjen e punesimit", Ligjit nr.15/2017, datë 16.02.2017 "Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë", Udhëzimit nr.12, datë 10.06.2021, të Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë "Për procedurat e pranimit e të emërimit të mësuesit në një vend të lirë pune në institucionet arsimore publike të arsimit parauniversitar dhe për administrimin e portalit "Mësues për Shqipërinë", Udhëzimit nr.14 datë 27.05.2021 "Për mënyrën e organizimit dhe veprimtarisë së institucioneve të arsimit dhe formimit profesional, si dhe aspektet e menaxhimit të burimeve njerëzore, përbërjes së njësisë së zhvillimit të ofruesve të arsimit dhe formimit profesional dhe zhvillimit të vazhduar profesional të personelit",

Ofruesi publik i AFP-se, Shkolla e Mesme Profesionale Charles Telford Erickson" Golem-Kavaje ju njofton krijimin e vendit te lire per pozicionin:

-Mesimdhënes i teorisë profesionale per drejtimin:Veteriner.

3.Kriteret e pergjithshme dhe kriteret e posacme.

Aplikanti për mesimdhënës të kulturës profesionale në ofruesit e AFP-së duhet të përmbushë këto kriteret:

1. Kriteret e përgjithshme:

- a) të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- b) të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën;
- c) të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e veprave penale;
- d) të mos ketë ndaj tij masa disiplinore që nuk janë shuar;
- e) të demonstrojë vlera të larta të etikës, sjelljes dhe komunikimit;
- f) të demonstrojë aftësi të punës në grup dhe të motivimit.

2. Kriteret e posaçme për personelin

mësimdhënës të teorisë profesionale në ofruesit e

AFP-së, që ofrojnë arsimit të mesëm profesional:

- a) të ketë diplomë të nivelit master profesional ose të barasvlershme, në të njëjtën fushë me njërin nga kualifikimet profesionale të ofruesit të AFP-së;
- b) të ketë të paktën 1 (një) vit përvojë pune në fushën, në të cilën ka kryer studimet;
- c) të njohë dhe të përdorë teknologjinë e informacionit;

Dokumentet e aplikimit.

1. Dosja e aplikimit, e cila përmban dokumentacionin e kërkuar, sipas njoftimit të vendit të lirë, duhet të përfshijë:

- a) letërmotivimin për pozicionin;
- b) jetëshkrimin (CV-në), sipas shtojcës 11 të këtij udhëzimi;
- c) kartën e identitetit;
- d) diplomën;
- e) librezën e punës;
- f) çdo dokumentacion tjetër që vërteton kualifikimet, trajnimet apo të tjera të përmendura në CV;
- g) certifikatë ose dëshmi për nivelin e njohurive në teknologjinë e informacionit;
- h) vërtetim të gjendjes shëndetësore;
- i) vërtetim të gjendjes gjyqësore;
- j) vërtetim nga punëdhënësit i fundit, që ndaj tij nuk ka marrë masa disiplinore në fuqi;
- k) të paktën një rekomandim ose vlerësim pune nga punëdhënësi të mëparshëm.

2. Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara të tyre. Dokumentet në gjuhën e huaj duhet të jenë të përkthyer në gjuhën shqipe dhe noterizuara.

3. Dokumentet e aplikimit dorëzohen në zyrën e protokollit të ofruesit publik të AFP-së, brenda datës. 02 . 04 . 2024.

Drejtore
Matilda Canaku

